

VENDIM
Nr. 475, datë 13.7.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA
INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/3 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Në shkronjën “a” shtohet emërtesa “Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor”;

ii. Në shkronjën “b”, emërtesa “Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” shfuqizohet.

b) Pika 10/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 7/1 (pjesët I, II, III dhe IV), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr. 7/1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, për politikatat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 7/1

I. Për Teatrin Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Regjisor. Aktor i parë.	84.750
2	Asistent regjisor. Aktor i dytë.	75.950
3	Skenograf i kategorisë së parë.	64.000

4	Aktor i tretë.	62.400
5	Skenograf i kategorisë së dytë.	53.000

II. Për Drejtorinë e Operës dhe Filarmonisë dhe Drejtorinë e Baletit, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Drejtor Artistik i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent (orkestre). Dirigjent (baleti). Solist i parë (lirik, baleti). Koncertmaestër. Baletmaestër. Dirigjent kori.	141.500
2	Spala sektori (orkestre).	134.600
3	Solist II (lirik, baleti, pianist). Spalë sektori (kori).	128.600
4	Asistent dirigjent. Orkestrant i kategorisë së parë.	123.900
5	Orkestrant i kategorisë së dytë.	118.600
6	Solist i tretë (lirik, baleti).	106.800
7	Korist i kategorisë së parë. Balerin i kategorisë së parë. Pianist korepetitor.	100.000
8	Korist i kategorisë së dytë. Pianist përgatitor. Balerin i kategorisë së dytë.	96.800

III. Për trupën artistike të Teatrit të Kukullave, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Dirigjent. Regjisor. Drejtues artistik.	75.950
2	Skenograf i kategorisë së parë. Mjeshtër i studios së cirkut. Mjeshtër profili i numrave të cirkut. Aktor i parë. Akrobat i kategorisë së parë.	64.000
3	Aktor i dytë. Skenograf i kategorisë së dytë. Akrobat i kategorisë së dytë.	53.000

IV. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Drejtor i Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Mjeshtër vallesh (korepetitor).	123.900
2	Solist i parë. Orkestrant i kategorisë së parë. Korist i kategorisë së parë. Valltar i kategorisë së parë.	100.000

3	Orkestrant i kategorisë së dytë. Valltar i kategorisë së dytë. Korist i kategorisë së dytë.	95.700
4	Solist i dytë. Orkestrant i kategorisë së tretë. Valltar i kategorisë së tretë. Korist i kategorisë së tretë.	78.000